- **UP 6 – parcela për gjelbërim me brez të plotë2**, me sipërfaqe prej 0,31.91 ha, në përbërjen e së cilës hyjnë pjesët e pk.nr.882/1 dhe 1082/1, të gjitha në KK Çukarkë,
- **UP 7 – parcela për gjelbërim me brez të plotë3**, me sipërfaqe prej 0,12.42 ha, në përbërjen e së cilës hyjnë pjesët e pk.nr.939/5, të gjitha në KK Çukarkë,
- **UP 8 – parcela për gjelbërim me brez të plotë4**, me sipërfaqe prej 0,07.89 ha, në përbërjen e së cilës hyjnë pjesët e pk.nr.882/1,882/3, 1082/1 dhe 1082/3, të gjitha në KK Çukarkë dhe
- **UP 9 – parcela për gjelbërim me brez të plotë5**, me sipërfaqe prej 0,50.09 ha, në përbërjen e së cilës hyjnë pjesët e pk.nr.584/1 dhe 1082/2, të gjitha në KK Çukarkë.

Parcelat e reja të formuara për destinime të reja

Tabela numër 2

Shenja e parcelës	Destinimi	Formimi i parcelës urbanistike për destinim publik		Sipërfaqja ndërtimore e Parcelës për destinim publik (ha)
		Numri i par.kad. në KK Çukarkë	Sipërfaqja (ha)	
		pk.nr. 590/2 (pjesë)	0,01.40	
		pk.nr. 590/5 (pjesë)	0,01.95	
		pk.nr. 591/1 (pjesë)	0,00.85	
		pk.nr. 592 (pjesë)	0,00.18	

UP1	Rruga komunale /e pakategorizuar (parcela 1)	pk.nr. 882/1 (pjesë)	0,28.92	0,71.26
			0,09.86	
		pk.nr. 882/3 (pjesë)	0,01.33	
		pk.nr. 939/1 (pjesë)	0,07.04	
		pk.nr. 939/4 (pjesë)	0,00.1	
		pk.nr. 939/5 (pjesë)	0,07.73	
		pk.nr. 988 (pjesë)	0,00.48	
		pk.nr. 989/1 (pjesë)	0,01.20	
UP2	Rruga komunale /e pakategorizuar (parcela 2)	pk.nr. 1082/1 (pjesë)	0,10.18	0,58.61
		pk.nr. 584/1 (pjesë)	0,15.82	
		pk.nr. 998/1 (pjesë)	0,18.68	
		pk.nr. 999 (pjesë)	0,05.56	
		pk.nr. 1053 (pjesë)	0,00.51	
UP3	Pjesa e autostradës E-75 me mbikalimin	pk.nr. 1082/2 (pjesë)	0,18.04	1,88.70
		pk.nr. 584/2 (e tërë)	0,40.73	
		pk.nr. 585 (e tërë)	0,05.29	
		pk.nr. 586/1 (pjesë)	0,00.26	
		pk.nr. 586/2 (pjesë)	0,05.98	
		pk.nr. 588/1 (pjesë)	0,09.11	
		pk.nr. 588/2 (pjesë)	0,09.34	
		pk.nr. 589/2 (e tërë)	0,05.62	
		pk.nr. 590/2 (pjesë)	0,16.84	
		pk.nr. 591/2 (pjesë)	0,04.73	
		pk.nr. 882/3 (pjesë)	0,02.40	
		pk.nr. 989/2 (e tërë)	0,16.39	
		pk.nr. 992/2 (e tërë)	0,02.03	
		pk.nr. 993/2 (e tërë)	0,05.38	
		pk.nr. 996/2 (pjesë)	0,04.53	
		pk.nr. 996/3 (e tërë)	0,00.68	
		pk.nr. 997 (pjesë)	0,03.82	
		pk.nr. 998/2 (pjesë)	0,01.67	
		pk.nr. 1026/2 (pjesë)	0,01.33	
		pk.nr. 1081/4 (e tërë)	0,03.04	
		pk.nr. 1082/3 (pjesë)	0,13.64	
		pk.nr. 1082/4 (e tërë)	0,01.36	
		pk.nr. 1088/1 (pjesë)	0,34.53	
UP4	Lumi i Tërnavës	pk.nr. 940 (pjesë)	0,22.18	0,43.58
		pk.nr. 1087 (pjesë)	0,21.40	
UP5	Gjelbërimi me brez të të plotë (parcela 1)	pk.nr. 882/1 (pjesë)	0,19.75	0,27.98
		pk.nr. 1082/1 (pjesë)	0,08.23	
UP6	Gjelbërimi me brez të plotë (parcela 2)	pk.nr. 882/1 (pjesë)	0,30.68	0,31.91
		pk.nr. 1082/1 (pjesë)	0,01.23	
UP7	Gjelbërimi me brez të plotë(parcela 3)	pk.nr. 939/5 (pjesë)	0,12.42	0,12.42
UP8	Gjelbërimi me brez të plotë (parcela 4)	pk.nr. 882/1 (pjesë)	0,02.06	0,07.89
		pk.nr. 882/3 (pjesë)	0,00.97	
		pk.nr. 1082/1 (pjesë)	0,04.43	
		pk.nr. 1082/3 (pjesë)	0,00.43	
UP9	Gjelbërimi me brez të plotë (parcela 5)	pk.nr. 584/1 (pjesë)	0,42.64	0,50.09
		pk.nr. 1082/2 (pjesë)	0,07.45	

Në shtojcën **numër 6**–“Planii riparcelizimit të sipërfaqeve publike me orientime për realizim” në proporcionin R 1:1.000, janë paraqitur parcelat urbanistike të destinimit publik, në kufijtë e përfshirjes në planin përfshirës, me elementet analitiko-gjeodezike të nevojshme.

Në pajtim me Nenin 67 të Ligjit për Planifikim dhe Ndërtim, ky Plan përmban planin e parcelizimit dhe

riparcelizimit për parcela urbanistike të destinimeve publike. Për nevojat e realizimit në operatin kadastral, është e nevojshme të bëhet projekti i shënimit gjeodezik.

B.3.Njehësimi i sipërfaqeve të tokës për destinim të planifikuar

Destinimi ekzistues i tokës

Tabela numër 3

Numri rendor	Destinimi i planifikuar	SipërfaqasIUPËRFAQAs Sipërfaqja (ha)	Përqindja e pjesëmarrjes (%)
1	Tokë ndërtimore	17,56	97,56
	1.1. Pjesë e rrugës shtetërore IA nr.A1 (autostrada E-75) me mbikalimin	1,89	10,50
	1.2. Pjesë e rrugës komunale/e pakategorizuar	1,30	7,22
	1.3. Gjelbërim në brezin e rrugës	1,30	7,22
	1.4. Sipërfaqe për prodhimtari industriale	13,07	72,62
2	Toka ujore	0,44	2,44
	2.1.Lumi i Tërnavës(shtrati i rregulluar)	0,44	2,44
Gjithsejt (prej 1 deri 3)		18,00	100

Ne shtojcën grafike **numër 4** – “Planifikimi i destinimit kryesor në kuadër të përfshirjes së planit me ndarjen në zona urbanistike” nëshkallën e zvogëlimit R 1:1.000, është paraqitur destinimi i planifikuar i hapsirave në hapsirën e përfshirë me Plan.

B.4.Kushtet urbanistike për sipërfaqet dhe objektet e infrastrukturës së komunikacionit dhe teknike

B.4.1. Infrastruktura e komunikacionit (komunikacioni rrugor)

Gjendja ekzistuese

Në hapsirën e planit, gjendet pjesa e rrugës komunale/epakategorizuar, e cila, nga Presheva, nëpërmjet Çukarkës, të çon deri tek vendbanimi i Mamincës. Në këtë pjesë, me komunikacion janë mbështetur dy lokacione, të cilat janë të përfshirë në këtë Plan, njëri nga ana perëndimore e korridorit të autostradës E-75 dhe tjetri nga ana lindore e korridorit të autostradës E-75.

Rruga komunale/e pakategorizuar lëndore, si e denivelizuar kryqëzohet (kalon mbi autostradën me mbikalim për Mamincë), me rrugën shtetërore të rendit IA numër 1 (me autostradën E-75), në stacionimin km 959+440(sipas PPPN të korridorit infrastrukturor Nish-kufiri me Republikën e

Maqedonisë), gjegjësisht stacionimi rreth km 578+812 (sipas sistemit referentues),

Në disa pjesë, rruga lëndore është nxjerrë jashtë parcelës kadastrale,gjegjësisht për disa pjesë, për trasën faktike të kësaj rruge, është e nevojshme të formohet parcela ndërtimore dhe të zgjidhen marrëdhëniet pronësore-juridike.

Zgjidhjet e planifikuara

Rrugët shtetërore

Në këtë dokument planifikues nuk janë të parapara kurrfarë intervenca në rrugët shtetërore, si dhe as kyçje në rrugët shtetërore. Kurrfarë intervenime nuk janë planifikuar edhe tek kalimi mbi autostradë, mbikalimin për Mamincë.

Rrugët komunale/të pakategorizuara

Më zgjidhjen urbanistike është paraparë formimi dhe definimi i parcelave ndërtimore të rrugës komunale/të pa kategorizuar Preshevë-Çukarkë-Mamincë, në të cilën janë të mbështetura hapsirat e përfshirë në këtë Plan.

Kyçja e komplekseve lëndore në pjesën e rrugës lëndore do të zhvillohet nëpërmjet kyçjeve të planifikuara të komunikacionit intern, me dimensione konform makinave meritore(makinat e transportit).

Rregullat e rregullimit dhe ndërtimit

Ndërtimi, si dhe rikonstruktimi dhe adaptimi i rrugës komunale/të pakategorizuara, të kryhet me shtresë bashkëkohore të rrugëve, me pjerrtësi dhe gjërësi të tërthortë të njëanshme në pajtim me profilet e paraqitura në pjesën grafike të Planit.

Të sigurohet kullimi i ujërave atmosferike nga sipërfaqja e rrugës, në pajtim me dispozitat teknike nga sfera lëndore.

Kyçjet rrugore të planifikuara të lokacioneve/kompleksit në rrugët komunale/të pa kategorizuara, të projektohen duke i plotësuar këto kushte:

- në pajtim me rregullativën ligjore ekzistuese nga sfera lëndore;
- me shtresë të njëjtë të rrugës, si dhe rrugën lëndore në të cilën kyçet, në gjerësi dhe gjatësi, që siguron lakimin pa pengesa dhe hyrje të makinës në lokacionin/kompleksin.
- sigurohet prioriteti i zhvillimit të komunikacionit në rrugën publike lëndore;
- zgjidhet në mënyrë adekuate pranimi dhe kullimi i ujërave sipërfaqësore, duke u harmonizuar me sistemin e kullimit të rrugës publike;
- gjysëm rrezja e lepezës në zonën e udhëkryqit të caktohet në baze të gjurmave dhe automjeteve meritore të cilat do të shfrytëzohen kyçjen e komunikacionit lëndor.

Trotuaret ndërtohen nga shtresat bashkëkohore, kurse rekomandohet shfrytëzimi i elementeve montazhuese të betonit, ose pllakat që mund të jenë me ngjyra, por të gjitha në funksion të shpirjes, ndarjes dhe sinjalizimit e destinimeve të ndryshme të sipërfaqeve të komunikacionit, që pos efektit të formimit dhe vizuel, ka qëllimin praktik të ndërtimit dhe rikonstruktimit i gjypave komunalë (instalacionet kyçëse). Gjerësia e trotuareve duhet të mundësojë kalueshmërinë e personave me nevoja të veçanta në pajtim me rregullativën ligjore.

B.4.2. Infrastruktura e komunikacionit (komunikacioni hekurudhor)

Gjendja ekzistuese

Hapsira lëndore gjendet në jug të vendbanimit të Çukarkës, nga ana e majtë e hekurudhës Beograd-Mladenovc- Lapovo- Nish- Preshevë- kufiri shtetëror (Tabanovc), drejtpërdrejt prapa kalimit rrugor në km 394+786, nga përballë km 394+790 deri në përballë km 395+104. Në pjesën lëndoretë hekurudhës gjenden dy lëshime nën hekurudhë, në km 394+825 dhe në km 395+104, me të cilën është rregulluar kullimi i trupit të hekurudhës dhe hapsirës përreth, e të cilën “Infrastruktura zeleznice Srbije” a.d. rregullisht e

mbajnë, ashtu që të mos rrezikohet stabiliteti dhe siguria e infrastrukturës hekurudhore publike.

Zgjidhjet e planifikuara

Është duke u hartuar dokumnetacioni teknik për rikonstruktimin dhe modernizimin e hekurudhës një trasëshe Nish-Preshevë-kufiri shtetëror. Është hartuar studimi “Modernizimi i Hekurudhës Trupale (Nish-Preshevë-kufiri me Maqedoninë).

Momentalisht po shqyrtohen variantet e propozuara të modernizimit të hekurudhës, me ç’rast zgjidhja më e pranueshme është ajo që përfshin riparimin e tërë hekurudhës me rritjen maksimale të shpejtësisë pa ndryshimin e trasës, pa ndryshimin e nivelit të hekurudhës dhe pa ndryshimin e brezit të shinave ekzistuese.

Gjithashtu planifikohet, në fazën e dytë, rikonstruktimi dhe modernizimi i hekurudhës me ndërtimin e trasës së dytë në pjesën Nish-Preshevë-kufiri shtetëror, ashtu që kjo në të ardhmën të bëhet hekurudha dytrasëshe e elektifikuar. Instituti i komunikacionit CIP në vitin 2000 ka hartuar projektin gjeneral të modernizimit të hekurudhës magjistrale E-85 Suboticë-Beograd-Nish – Preshevë- kufiri me Maqedoninë, për shpejtësitë deri në 200 km/h, pjesa Nish-kufiri me Maqedoninë. Me projektin, është paraparë trasa e dytë në trasë të re me gjatësi 156 km, që është paraparë edhe me strategjinë e zhvillimit të hekurudhës, transportit rrugor, ujqor, ajror dhe intermodal në Republikën e Serbisë. Me dokumentet e cekura të planifikimit janë propozuar dy variante korridoresh të shinave, kështu që me variantin e dytë është paraparë largimi i korridorit lindor nga binarët ekzistues me ndërtimin e anës tjetër Preshevë te kryqëzimi i denivelizuar me rrugën. Varianti i cekur do të kalonte nëpërmjet hapsirës së planifikuar lëndore, por “Infrastruktura zeleznice Srbije” a.d., nuk e ka të punuar dokumnetacionin teknik për hekurudhën e cekur.

Rregullat e rregullimit dhe ndërtimit

Me këtë dokument planifikimi në tërësi është mbajtur toka hekurudhore, si tokë e destinimit publik, me destinimin ekzistues – për komuniacionin hekurudhor publik.

“Infrastruktura zeleznice Srbije” a.d. mban korridoret e hekurudhës ekzistuese, si dhe tërë tokën mbi të cilën ka të drejtë shfrytëzimi.

Me dokumentet e planifikimit nuk planifikohen udhëkryqet tjera të komunikacionit rrugorë në nivel me hekurudhën ekzistuese. Kyçja në lokacionin lëndor të planifikohet nga rruga Çukarkë-Mamincë, ose nëpërmjet kalimit rrugor ekzistues në km

394+786 të siguruar me shenjat e komunikacionit në rrugë dhe trekëndëshet e pamjes.

Është i mundur planifikimi i komunikacionit rrugor paralel me trasën e hekurudhës ekzistuese, por në mënyrë që distanca ndërmjet hekurudhës dhe rrugës të jetë ashtu që nëpërmjet tyre mund të vendosen të gjitha aparatet dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e komunikacionit në hekurudhë dhe rrugë, ashtu që shuma të jetë më së paku 8m duke llogaritur paralel aksin e trasës më të afërme deri të pika më e afërt e shtresës më të lartë të rrugës, dhe jashtë kufirit të tokës, të cilin e shfrytëzon hekurudha.

Gjatë hartimit të planit lëndor, objektet afariste sipas rregullit të planifikohen jashtë brezit infrastrukturor të hekurudhës lëndore, që nënkupton që skaji më i afërt i objektit të jetë në largësi minimum 25 m, matur në bazë të trasës më të afërt. Objektet të planifikohen jashtë kufirit të tokës të cilën e shfrytëzon hekurudha.

Objektet, siç janë: xeheroret, gurthyesit, gëlqeroret, fabrikat e tullave, ndërtesat industriale, instalimet dhe objektet tjera të ngjashme nuk mund të ndërtohen në brezin mbrojtës, më së afërmi prej 50 m, duke llogaritur paralel me boshtin e trasës përfundimtare. Duhet të planifikohet vënia e rrethores në pjesën kah hekurudha, por ashtu që e njëjta të jetë në distancë më së paku prej 1m nga baza e bregut dhe jashtë kufirit të tokës që shfrytëzon hekurudha.

Në brezin e infrastrukturës mund të vëhen kabllot, përçuesit elektrik të tensionit të ultë për ndriçim, linjat ajrore telegrafike dhe telefonike, përçuesit dhe instalimet e tramvajit dhe trolejbusit, gypat e ujësjellsit dhe kanalizimit, përçuesit tjerë, objektet dhe instalimet e ngjashme në bazë të pëlqimit të dhënë të drejtuesit të infrastrukturës që lëshohet në formë të aktvendimit.

Në brezin e infrastrukturës të mos planifikohen formimet e deponive të mbeturinave materiale dhe trasat e instalimeve për kullimin e ujërave sipërfaqësore dhe ujërave të zeza, ashtu që çojnë kah trupa e hekurudhës.

Në brezin mbrojtës është e mundur të planifikohet rregullimi i hapsirave të gjelbërta, me ç'rast duhet të kihet kujdes që drunjt e lartë të jenë patjetër në distancë më shumë se 10 m, duke llogaritur nga skajshmëria e jashtme e brezit.

Nuk guxon të mbillen drunj të lartë, të vëhen shenja, burime të dritës së lartë, ose çfarëdo lëndë dhe aparate, të cilat me ngjyrën, formën ose ndriçimin zvogëlojnë të pamurit e sinjaleve hekurudhore ose që mund të ngatërrojnë punëtorët në lidhje me kuptimin e shenjave sinjalizuese.

Kryqëzimi i përçuesve, kanalizimit, produkteve të ujit dhe gypave të ujësjellsit me hekurudhën, është e mundur të planifikohet me këndin prej 90°, veçanërisht mund të planifikohet me këndin jo më të vogël se 60°. Thellësia e gropimit nën hekurudhë patjetër duhet të jetë në minimum prej 1,80m, matur nga kota e skajit të lartë të pragut deri në kotën e lartë të skajit të gypit mbrojtës të ujësjellsit (produkteve të ujit).

Brezi përcjellës është brezi tokësor nga të dyja anët e hekurudhës në gjerësi prej 8m, në vendbanim 6m, duke llogaritur nga aksi i trasës përfundimtare, toka mbi hekurudhë dhe hapsirë ajrore në lartësi prej 14m. Brezi infrastrukturor është brezi tokësor nga të dyja anët e hekurudhës në gjerësi prej 25m, duke llogaritur nga aksi përfundimtar i trasës që funksionalisht shërbejnë për shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin teknologjik të kapaciteteve infrastukture. Në bazë të dispozitave ligjore nga sfera e planifikimit dhe ndërtimit, “Infrastruktura železnice Srbije” a.d. si bartës i kompetencave publike, ka për detyrë caktimin e kushteve për ndërtimin e objekteve, gjegjësisht dhënien e kushteve të lokacionit, lejes së ndërtimit dhe përdorimit, kushtet për kyçjen në rrjetin infrastrukturor, si dhe regjistrimin e të drejtës së pronësisë në objektin e ndërtuar. Në pajtim me këtë, të gjitha elementet tjera për rregullimin dhe ndërtimin e hapsirave lëndore do të definohen në kuadër të kushteve të veçanta teknike “Infrastruktura železnice Srbije” a.d.

B.4.3. Rrjeti infrastrukturor dhe objektet

B.4.3.1. Rregullat e përgjithshme

Objektet dhe rrjetat komunale, gjegjësisht infrastrukturat teknike të kryhen në pajtim me kushtet teknike dhe normative të parashikuara për çdo lloj të infrastrukturës dhe në pajtim me dispozitat mbi drejtimin paralel dhe të kryqëzuar e gypave të infrastrukturës.

Kryqëzimi dhe drejtimet paralele të instalimeve(rruga shtetërore).

Trasa e instalimeve duhet me projekt të harmonizohet me instalimet ekzistuese pranë dhe nën rrugët shtetërore.

Rregullat për kryqëzimin e instalimeve me rrugën shtetërore:

- Kryqëzimi i instalimeve me rrugën shtetërore planifikohet kryesisht me shpuarjet mekanike, nën trupin e rrugës, drejt në rrugë, në gypin mbrojtës të parashikuar.
- Gypi mbrojtës duhet të projektohet gjatë tërë gjatësisë, ndërmjet pikave të skajshme të profilit të tërthortë të rrugës(përrjashtimisht

skaji i jashtëm i trasës së rikonstruuar), e rritur për 3.0m nga çdo anë.

- Thellësia minimale e instalimit dhe gypave mbrojtës nga kota më e ultë e trasës deri te kota më e lartëe gypit mbrojtës kapë 1.50m.
- Thellësia minimale e instalimeve lëndore dhe gypave mbrojtës nën kanalet e rrugës për kullim (ekzistues ose të planifikuar) nga kota e fundit e kanalit deri te kota më e lartëe gypit mbrojtës të jetë 1.20m.
- Gjatë vendosjes së instalimeve mbitokësore, zakonisht, duhet të kihet parasysh që shtyllat të vendosen në distancën e cila nuk mund të jetë më e vogël se lartësia e shtyllës së matur nga skaji i jashtëm i brezit tokësor të rrugës, si dhe të sigurohet lartësia e sigurisë prej 7.0m nga kota më e lartëe e trasës deri te zinxhiri, gjatë kushteve më të papërshtatshme klimatike.

Rregullat për drejtimin paralel të instalimeve pranë rrugës shtetërore:

- Instalimi duhet të bëhet minimalisht 3.0 m prej pikës së skajshme të profilin të tërthortë të rrugës shtetërore lëndore (këmbët e mbushjes së trupit të rrugës ose buzët e lidhura të kanalit të rrugës për kullim), përjashtimisht buzët e trasës së rikonstruuar (nëse me të nuk çrregullohet regjimi i kullimit të trasës).
- Nëse nuk është e mundur të plotësohet kushti i përmendur, duhet të projektohet dhe të kryhet mbrojtja adekuate e trupit të rrugës lëndore.
- Nuk lejohet shtrirja e instalimit nëpërmjet bankinës, nëpër pjerrësit e prerjes ose mbushjes, nëpërmjet lokacioneve të cilat mund instalimet për hapjen e rrëshqitjeve.

Kryqëzimi dhe shtrirja paralele e instalimeve (rrugët komunale /të pakategorizuara)

Gjatë vënies nëntokësore të instalimeve pranë dhe nën rrugë publike, është e nevojshme të plotësohen këto kushte:

- Kryqëzimi i instalimeve me rrugët publike planifikohet, varësisht nga shtresa e trasës, me gropëzim ose shpuarje, me vendosjen e të njëjtës në gypin mbrojtës të paraparë;
- Thellësia minimale e instalimit dhe gypave mbrojtës nga kota më e ultë deri në kotën më të lartëe të gypit mbrojtës duhet të jetë 1.0 m;
- Gjatë drejtimit paralel, instalimet duhet vendosur përkaj skajit të parcelës rrugore, pa e rrezikuar profilin e tërthortë të rrugës lëndore si dhe sistemin e kullimit të ujërave atmosferike, e nëse nuk është e mundur të plotësohet ky kusht, duhet të projektohet dhe

kryhet mbrojtja adekuate e trupit të rrugës lëndore.

B.4.3.2. Furnizimi me ujë

Gjendja ekzistuese

Në kompleksin që gjendet në perëndim në raport me korridorin e autostradës E-75 gjendet pusi ekzistues dhe janë ndërtuar gypat e ujsjellësit Ø120 mm, që rrezikohet për shkak të ndërtimit në kompleksin lëndor dhe duhet të bartët.

Në kompleksin që gjendet në lindje në raport me korridorin e autostradës E-75, nuk është ndërtuar rrjeti i ujsjellësit të qytetit, as që është planifikuar në të ardhmen.

Zgjidhja e planifikuar

Për mbrojtjen adekuate të infrastrukturës së ujsjellësit publik, është planifikuar bartja e gypave përçues Ø120 mm, nëpër trasën e re, që shkon për skaj kompleksit lëndor.

Me rrjetin e ujsjellësit të planifikuar duhet të sigurohet furnizimi me ujë gjithë harxhuesve të ujit, si dhe mbrojtja nga zjarri, në pajtim me dispozitat ligjore.

Furnizimi me ujë i kompleksit që gjendet në perëndim në raport me korridorin e autostradës E-75 do të zgjidhet me kyçjen në rrjetin e ujsjellësit publik/ose alternativa nga pusi i vet, kurse furnizimi me ujë i kompleksit që gjendet në lindje në raport me korridorin e autostradës E-75 do të sigurohet me ndërtimin e pusit në lokacionin lëndor.

Në kuadër të dy lokacioneve, është planifikuar ndërtimi i rrjetit intern të ujsjellësit, ashtu të dimenzionuar që siguron presion të mjaftueshëm dhe sasi të mjaftueshme të ujit për nevojat sanitare dhe kundër zjarrit.

Mbetet lokacioni i pusit, që është në sistemin e furnizimit publik të ujit, me zonën rrethuese të paraparë të mbrojtjes sanitare të drejtpërdrejt.

Rregullat e rregullimit dhe ndërtimit

Për pusin ekzistues duhet të hartohet laborati për zonat e mbrojtjes sanitare, nëpajtim me dispozitat ligjore nga sfera lëndore.

Dimenzionet e linjave të ujsjellësit të caktohen në bazë të llogaritjeve hidraulike, duke marrë parasysh sasinë e duhur të ujit për fikjen e zjarrit, në pajtim me dispozitat ligjore.

Thellësia minimale e gropëzimit të gypave të ujsjellësit është 1.2 m nga maja e gypave deri te kota

e terrenit, kurse rëniet sipas dispozitave normative teknike, varësisht nga diametri i gypave.

Nëse rrjeti hidraulik furnizohet me ujë me presion jo të mjaftueshëm (presioni minimal i nevojshëm është 2.5 bari) e detyrueshme është vendosja e aparatit për rritjen e shtypjes.

Distanca horizontale ndërmjet gypave të ujësjellësit dhe të kanalizimit, ndërtesave dhe objekteve tjera ekzistuese, nuk guxon të jetë më e vogël se 2.5 m.

Distanca e gjypave të ujit nga instalimet tjera (elektroenergjetike, kabllot e infrastrukturës së komunikacionit elektronik) gjatë kryqëzimit, nuk guxon të jetë më pak se 0.3 m.

Duhet të tentohet që gypat e ujësjellësit të jenë mbi gjypat e kanalizimit, kurse nën kabllot e elektroenergjetikës gjatë kryqëzimit.

Distanca minimale afër skajit të gypit deri te themelet e objekteve është 1.5 m.

Në kuadër të dokumentacionit teknik, duhet të sigurohet mbrojtja kundër zjarrit, në pajtim me dispozitat ligjore dhe kushtet teknike në lokacion.

B.4.3.3.Rregullimi i rrjedhave të ujit

Në përfshirjen e Planit, gjendet pjesa e rrjedhës së ujit të Lumit të Tërnavës. Në zgjidhjen e planit, është planifikuar toka e nevojshme për rregullimin e këtij lumi, e me qëllim të lidhjes së dy zonave të veprimtarisë afariste-prodhuese, është planifikuar ndërtimi i urës.

Rregullat e rregullimit dhe ndërtimit

Rregullimi i rrjedhave natyrore të ujit zakonisht bëhet me profilet e hapura. Dimenzionimi i profilit bëhet për mundësinë e depërtimit të ujërave të mëdha meritore që caktohet në pajtim me kategorizimin e rrjedhave të ujit.

Në zonën jo të mbrojtur, gjatë rrjedhës së ujit nuk guxon të vendosen objektet që mund të rrezikohen me ujërat e mëdha nga rrjedha e ujit e as të zvoglojnë fuqinë e depërtimit të shtratit dhe të rrezikojnë funksionalitetin dhe stabilitetin.

Pengesat vertikale në rrjedhat e ujit (urat, lëshimet etj.) duhet të jenë ashtu të dimenzionura që mos të ngadalësojnë rrjedhën e ujërave të mëdha meritore.

Për të gjitha kryqëzimet e rrjedhave të ujit me komunikacionet (urat ...)të bëhet përlllogaritja hidraulike për ujërat e mëdha, ekziston gjasa e brezit Q1%, dhe të parashihet (zazor)neveritje $h=1.00$ m(nga

kota e ujit të madh deri tek skaji i vogël i konstrukcionit);

Shtrati i rrjedhës së ujit duhet të kryhet në atë mënyrë dhe prej atyre materialeve që nuk mund të vijë deri tek deformimet morfologjike të mëtejshme si nga aspekti i thellimit ose në pikëpamje të ndryshimit të trasës së rregullimit.

Me punët e rregullimit nuk guxon të rrezikohet stabiliteti i objekteve ekzistuese ose të planifikuara përgjatë trasës së rregullimit.

Objektet dhe instalimet e infrastrukturës (elektroenergjetike, EK infrastrukturës, gasit etj.) që kryqëzohen ose paralelisht udhëhiqen me trasën e rregullimit duhet të vendosen ashtu që të jenë jashtë prekjes së ujërave të mëdha meritore.

Të gjitha derdhjet e ujërave atmosferike duhet të kryhen në pajtim me dispozitat, për të penguar degradimin dhe prishjen e stabilitetit të pjerrtësisë së lumenjve dhe kanaleve. Në vendet e derdhjes së kanalizimit atmosferik, në zonën e derdhjes të parashihet harmonizimi me profilin dhe sigurimin e pjerrtësisë dhe fundit në qëllim të ndalimit të erozionit të shtratit. Derdhja duhet të jetë në minimum 30 cm mbi fundin e shtratit.

Ndërtimi i profilit në prerje dhe mbushje kryhet ashtu që paraprakisht heqja e shtresës së humusit dhe me bartjen e tyre në deponinë e paraparë. Pas përfundimit të ndërtimit, pjerrtësitrat humuzohen dhe mbillen me bari, që mëndej gëmushet me qëllim të mbrojtjes nga shpërlarja e shtresës sipërfaqësore.

Materialet për mveshjen e shtratit zakonisht janë gurë të rrafshë të madhësisë 20-40 cm ose mbështjellës të betonit.

Shtresa e shtratit të rregulluar vendoset në tamponët prej materialit të rërës ose shlakës.

Objektet përgjatë rregullimit të rrjedhës së ujit, patjetër duhet të jenë larg minimalisht 5.0 m, për ruajtjen e korridorit për rekonstruktimin eventual (rritja e profilit të lëshimit) dhe për sigurimin e hapsirës për investimet e mirëmbajtjes së rregullt.

Në rastet e ndërtimit favor për rregullimin e rrjedhës së ujit të jepen zgjidhjet me të cilat shikohet tërësia teknike-tehnologjike për fazën përfundimtare.

B.4.3.4. Kullimi i ujërave atmosferike dhe ujërave të zeza.

Gjendja ekzistuese

Në hapsirën e Planit nuk është ndërtuar rrjeti i qytetit për kullimin e ujërave atmosferike dhe ujërave të

zeza, as që është planifikuar me planet zhvillimore të institucioneve kompetente.

Zgjidhja e planifikuar

Është planifikuar ndërtimi i rrjetit intern për kullimin e ujërave sanitare-fekale dhe gropave septike ujëjолëshuese (me zbrazje të përkohshme të përmbajtjeve nga ana e ndërmarrjes kompetente komunale), për çdo kompleks veç e veç. Si alternativë mund të ndërtohet instalimi për pastrimin e ujërave të zeza (PPOV) për çdo lokacion në vete.

Për çdo lokacion është planifikuar ndërtimi i kanalizimit atmosferik, që do të mundësojë kullimin e ujërave atmosferike nga rrugët, kulmet e objekteve dhe hapsirave tjera të caktuara brenda hapsirës së vëzhguar deri te recipienti. Ujërat atmosferike me yndyrim (nga parkingu dhe hapsirat manipulative), paraprkisht të trajtohen në seperator për vaj dhe yndyrna, para se të lëshohen në kanalizimin atmosferik. Zhvillimi i kanalizimit atmosferik ka për qëllim të mbrojë hapsirat e urbanizuara brenda zonës dhe reparteve industriale nga vërshimi i ujërave atmosferike. Kanalizimi atmosferik të konceptohet për kushtet meritore (prerja kohore, hapsira urbanistike, shirat e përlllogaritura etj.)

Rregullat erregullimit dhe ndërtimit

Rrjeta e kanalizimit sanitar-fekal të planifikohet nga gypi kanalizues i profilit të caktuar.

Tek rrjeti i kanalizimit nuk duhet të miratohet kolektori me dimenzionet më të vogla se Ø200mm.

Thellësia minimale e gropëzimit të kolektorit të kanalizimit të rrjetit primar parashikohet për shkak të mbrojtjes së tyre nga mrazi më së paku :

- 0,8 m për mbrojtje nga dridhjet e komunikacionit;
- 1,0 deri 1,5 m, që edhe nga dyshemeja më e ulët në hapsirë mundet uji i shfrytëzuar të kalojë me gravitacion deri tek kanali i rrugës;
- Kota e derrjes më të ultë duhet të jetë 0,30 cm më e lartë nga kota e kapakut të shahtës së kyçjes.

Thellessia më e madhe e gropëzimit varet nga kushtet gjeologjike, hidrogjeologjike dhe gjeomekanike vendore, si dhe nga peshëmbajtja e gypave të cilat vendosen. Thellësia e ndërtimit tëkanalit në kanalin e hapur zakonisht kurrë nuk është më e madhe se 6.0 deri në 7,0 m. Mbi këtë thellësi kalohet në ndërtimin e tunelit ose në sistemin e kanalizimit me pompa. Në tokat e këqija, veçanërisht kur është prezent niveli i lartë i ujërave nëntoksore, thellësia e gropëzimit nuk duhet të jetë mbi 4.0 m.

Në vendet e ndërrimit të drejtimit si dhe në drejtimet në gjatësi maksimale në afër 160D parashihet ndërtimi i shahteve të revizionit.

Shahtet ndërtohen prej unazave të armuar-betonit Ø1000 mm me përfundim konusal me përpunimin e lidhjeve.

Për tejkalimin e dallimeve të lartësisë shfrytëzohen dy tipe të shahteve kaskade. Për dallimet e lartësisë ndërmjet gypit prurës dhe fundit të shahtës deri në 1.5 m është i paraparë shahti kaskad, në të cilin uji lirisht derdhet nga gypi prues. Për tejkalimin e lartësive më të mëdha shfrytëzohet shahta me llulon derdhëse, ashtu që një pjesë e ujit derdhet në shahtë nëpërmjet saj, kurse pjesa tjetër derdhet lirshëm.

Nëse nuk është e mundur, kullimi i ujërave të zeza me gravitacion, është parapar ndërtimi i stacioneve thithëse në tipet e shahteve.

Vëllimi i gropës septike pa lëshim, përlllogaritet sipas harxhimit të ujit dhe kohës së zgjatjes së procesit, kurse gropat septike palëshim të vendosen :

- Min. 2m nga rrethimi i kompleksit;
- Min.5m nga objekti
- Min. 10m nga linja rregullative;
- Min. 20m, nga pusi

Dimenzionimi i kanalizimit atmosferik të bëhet në pajtim me përlllogaritjet hidraulike, kurse në bazë të derdhjes specifike.

Nëse sipërfaqja e asfaltit të yndyrosur (në kuadër të parkingut, platos etj.) e detyrueshme është të parashihet ndërtimi i separatorit të vajit dhe yndyrës, para lëshimit të ujit atmosferik ose ujërave nga larja e platos në kanalizimin atmosferik.

Ujërat atmosferike, kushtimisht të pastra mund të lëshohen në kanalizimin e shirave ose në hapsirat e gjelbërta në kuadër të lokacionit.

B.4.3.5. Infrastruktura elektroenergjetike

Gjendja ekzistuese

Në lokacionin lëndor ekzistojnë objekte elektroenergjetike të cilat janë në pronësi të O.D.S/“EPS Distribucija” dega e Elektrodistribucionit Vranjë, si dhe trafostacionet MBTS 10/0.4 kV 2x630 kVA, njëra në zonën në perendim në raport me korridorin e Autostradës E-75, kurse e dyta në zonën në jug në raport me korridorin e autostradës E-75, të cilat ende nuk janë bartë në mjete themelore ED Vranje. Përfshirja e planit pret largpërçuesin të intenzitetit të mesëm 10kV “Preshevë-Çukarkë-Sllavujevc”

Zgjidhja e planifikuar

Në zonën në perëndim në raport me korridoin e autostradës E-75 është planifikuar rekonstruktimi TS 2X1.000 kVA ekzistuese ose ndërtimi i të resë, që mvaret nga karakteristikat ndërtimore të TS ekzistuese. Kyçja TS do të bëhet me vendosjen e kablrit të intenzitetit mesatar, gjegjësisht largpërçuesit deri në TS 119/10 kV “Preshevë” të fuqisë 1x31,5MVA, ku është planifikuar pajisja komplete e qelis burimore matëse. Largpërçuesi i planifikuar 10kV që kyçet në qelinë burimore 10kV në TS 110/10 kV “Preshevë”, duhet të ndërtohet në shtyllat e betonit me përçuesin me diametër 3x70mm³(min 3x50mm²), 10kV, kurse futja e të njejtit në TS 10/0,4kV, MBTS 2x1000kVA do të bëhet me kablorin 10kV të tipit 3x1x150/mm² XHE 49-A(njëfijësh) ose NPO 13-AS 3x15mm²(trefijësh) sipas rekomandimit teknik EPS-a, TP13.

Kyçja e objekteve të planifikuara që do të ndërtohen në hapsirën e planifikuar me TS10/0,4kV përkatëse, do të bëhet me kabllot me intenzitet të nivelit 1kV të shtrira nga TS furnizuese deri në KPK në fasadat e objekteve, në tërësi sipas Rregullores mbi normativat teknike për instalimet elektrike të tensionit të ulët.

Nëse është për hapsirën në veri të autostradës, është e nevojshme të sigurohet furnizim i pandërprerë pos rrjetit furnizues nga TS 110/10 kV “Preshevë”, deri te TS e planifikuar, do të sigurohet edhe furnizimi rezerv nëpërmjet DEA- dizel agregatit elektrik të fuqisë përkatëse të vendosur së bashku me TS. Agregati duhet të jetë i tipit kontejner, për montim të jashtëm, duke i siguruar masat e pengimit të depërtimit të tensionit nga DEA në sistemin distributiv.

Nëse ekzistojnë mundësitë teknike TS ekzistuese në pjesën perëndimore të hapsirës planifikuese duhet rekonstruktuar në fuqinë 2x1000kVA, e nëse kjo nuk është e mundur, paraprakisht duhet ndërtuar TS MBTS 2x1000kVA të re, në lokacionin përrreth TS ekzistuese, duke e siguruar kyçjen në sistemin distributiv, me ndërtimin e largpërçuesit të ri 10kV nga TS 110/10kV “Preshevë”. Pas aktivizimit të TS 10/0,4kV të re, TS të fuqisë 2x630kVA ekzistuese duhet demontuar.

Në zonën lindore në raport me korridorin e autostradës E-75, mbahet infrastruktura elektroenergjetike ekzistuese, ashtu që perspektivisht e mundur rekonstruktimi i ekzistueses, gjegjësisht ndërtimi i TS së re, duke e pasur parasysh që në këtë moment nuk janë plotësisht të njohura nevojat elektroenergjetike në të ardhmen.

Tek kjo TS ekzistuese është e nevojshme të sigurohet furnizimi rezervë nëpërmjet kyçjes kabllore 10kV në largpërçuesin ekzistues 10kV “Preshevë-Çukarkë-Sllavujevc”. Për lidhjen TS 10,4kV në rrjetin 10kV të

tensionit të mesëm, duhet shfrytëzuar kabllorët 6/10kV të ngjashëm me tipin 3x1x150/mm² XHE 49-A(një fijor) ose NPO 13-AS 3x15mm²(trefijor), të zgjedhur sipas dispozitave të rekomandimit teknik EPS-a, TP13.

Për nevojat e ndriçimit publik të shfrytëzohen kabllot të tipit p00-A 4x16mm².

Rregullat e rregullimit dhe ndërtimit

Trafostacioni të ndërtohet si shtyllor ose montazh-betonit, në pajtim me dispozitat ligjore valide dhe kushtet teknike të ndërmarrjes elektrodistributiv ekompetente. Pos trafostacionit lejohet edhe ndërtimi i dizel-agregatit.

Tek vendosja e kabllorëve energjetik, është e nevojshme të sigurohet distanca minimale nga llojet tjera të instalimeve dhe objekteve, e që janë:

- 0.4 m nga gypat e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- 0.5 m nga kabllori i infrastrukturës së komunikacionit elektronik dhe themelet e objekteve ndërtimore
- 0.8 m.....nga përcjellësi i gazit në vendbanim,
- 1.2 m.....nga përcjellësi i gazit jashtë venbanimit.
- Nëse distancat e nevojshme nuk mund të sigurohen, kabllorët elektrik shtrihen në gypat mbrojtës, të gjatësisë më së paku 2.0 m nga të dy anët e vendit ku kryqëzohen ose në tërë gjatësinë të përcjellja paralele, me ç’rast distanca nuk mund të jetë më pak se 0.3 m.

Nuk është e lejuar përcjellja paralele e kabllorëve energjetikë mbi ose nën përcjellësit e gazit, përcjellësit e nxehtësisë dhe gypave të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Te kryqëzimi i kabllorit energjetik me kabllot e elektrokomunikacionit, kabloja energjetike vendoset nën kabllon e elektro komunikacionit, kurse këndi i kryqëzimit duhet të jetë më së paku 30°, gjegjësisht sa më afër 90°.

Në kalimin mbi komunikacionet, kabllorët energjetike vendoset në gypin mbrojtës ose në kabllot e betonit, në thellësinë minimale 0.8 m nën sipërfaqën e rrugës(trasës), varësisht nga kategoria e rrugës publike. Në stazat e këmbësorëve, kabllorët energjetike vendoset në kanale ose gypa, ashtu që i njejt nuk mund të shfrytëzohet për përcjelljen e ujit atmosferik. Në rrugën shtetërore, kabloja vendoset varësisht kushteve të drejtuesit të rrugës shtetërore.

Ndriçimi publik sipas rregullit ndërtohet për rreth rrugëve në trotuare ose në brezin e gjelbërt, në largësi prej 0.5m deri tek trasa e rrugës. Pranë rrugëve

shtetërore ndriçimi publik vendoset sipas kushteve të drejtuesit të rrugës shtetërore.

B.4.3.6. Infrastruktura e komunikacionit elektronik

Gjendja ekzistuese

Sipas kushteve të ndërmarrjes kompetente, në hapsirën e planifikuar, janë objektet e ndërtuara të infrastrukturës së komunikacionit elektronik (TK kanalizimi, rrjeti optik dhe rrjeti i parapagesës)

Zgjedhja e planifikuar

Në të dy lokacionet, kyçja e objekteve të planifikuara do të mundësohen me ndërtimin e përcjellësit optik, ndërmjet vazhdimit më të afërm të vendosjes së kabllos optike dhe koncentrimi i instalimeve në hapsirën lëndore.

Rregullat e rregullimit dhe ndërtimit

Rregullat e rregullimit dhe ndërtimit të rrjetit të komunikacionit elektronik nëntoksor (EK) janë:

- EK rrjeti të ndërtohet në koridoret e rrugës publike dhe hapsirat e destinimeve publike;
- Thellësia e vendosjes së kabllos duhet të jetë më së paku 0.8-1.2 m;
- Të planifikohen PVC gypat Ø110 mm në vendet e kryqëzimit të kabllove me trasën e rrugës, si dhe nën sipërfaqet e betonit dhe asfaltit në trasat e kabllove, për të evituar gërmimin e mëtejshëm;
- Mbrojtja e EK korridorit dhe ndërtimi i objekteve infrastrukturore etj. në afërsi të korridoreve elektrokommunikacioneve duhet të jetë në pajtim me Rregulloren mbi kërkesat për vërtetimin e brezit mbrojtës për rrjetet e elektrokommunikacionit dhe mjeteve aksesore të radio-korridoreve dhe zona mbrojtëse dhe mënyra e kryerjes së punëve me rastin e ndërtimit të objekteve (“Sluzbeni glasnik RS”, nr.16/12);
- Me punët e planifikuara nuk mund të vijë deri te rrezikimi i stabilitetit mekanik dhe karakteristikave teknike të EK objekteve dhe kabllove ekzistuese, as deri te rrezikimi i funksionimit normal të komunikacionit dhe duhet gjithnjë t’u sigurohet qasje kabllove ekzistuese, për mirëmbajtjen e rregullt e tyre dhe intervencat eventuale.
- Nëse ndërtimi lëndor kushtëzon bartjen e objekteve/kabllove të EK ekzistues, është e nevojshme të hartohet zgjidhja teknike/projekti i bartjes, mbrojtja dhe sigurimi i kabllove të EK ekzistuese, që janë pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik të ndërtimit lëndor;
- Të gjithë investitorët janë të detyruar që t’i përmbahen Ligjit mbi Komunikacionin

Elektronik si dhe udhëzimet e Agjencionit Republikan për Komunikacion Elektronik (RATEL) mbi realizimin e kërkesave teknike dhe tjera, gjatë ndërtimit të rrjetit të komunikacionit elektronik dhe mjeteve që i takojnë në objektet afariste dhe të banimit, gjegjësisht të mundësohen kushtet e barabarta për afarizmin e të gjithë operatorëve.

B.5. Zona e gjelbërt

Është planifikuar gjelbërimi i gjithë gjatësisë së korridorit të rrugës publike, ashtu që tërësisht të plotësohen kërkesat në pikmaje të pamjes dhe sigurimi i zhvillimit të komunikacionit.

Në kuadër të rregullimit të shtratit të Lumit të Tërnavës, është planifikuar peisazhi i rregullacionit me llojet përkatëse të sipërfaqeve të gjelbërta.

Brenda lokacioneve të planifikuara është e nevojshme të sigurohet minimalisht 10% të sipërfaqeve të gjelbërta nga sipërfaqja e përgjithshme të parcelave ndërtimore. Gjelbërimet e planifikuara patjetër duhet të jenë në funksion të pasurimit të kompozimeve të përgjithshme urbanistike-arkitekturore, në pajtim me nevojat e shfrytëzuesve.

Në kuadër të kufijve të parcelave ndërtimore, rregullimi isipërfaqeve të gjelbërta të zgjidhën në pajtim me zgjidhjet e komunikacionit urbanistik dhe ndërtimor, si dhe me trasat e instalimeve nëntokësore.

Para ndërtimit të punëve duhet të largohet shtresa e humusit, të ruhet dhe pas përfundimit të punëve të shfrytëzohet në sanimin e lokacionit.

Është e preferueshme vendosja e rrjeteve hidraulike, në lokacionet lëndore për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta, kurse me zgjidhet e nivelacionit të mundësohet rrjedha e drejtë e ujërave atmosferike në drejtim të grykderdhjeve.

Zgjedhja e mbjelljeve të bazohet në llojet autoktone dhe të formohen barishtet nga llojet e barit më të qëndrueshëm. Nuk lejohet zbatimi i llojeve invazive, gjatë rregullimit të sipërfaqeve të gjelbërta dhe ngritjes së gjelbrimit mbrojtës nëpër skajet e komplekseve lëndore.

B.6. Masat urbanistike të mbrojtjes

B.6.1. Masat mbrojtëse të mjedisit jetësor

Në qëllim të mbrojtjes së mjedisit jetësor në hapsirën e planit dhe më gjerë, janë definuar masat për kufizimin e ndikimit negativ dhe rritjes së ndikimit pozitiv në mjedisin jetësor. Masat janë definuar në

vlerësim të gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor, natyror dhe vlerat e krijuara, kapacitetet e mjedisit jetësor dhe përmbajtja e planifikuar.

Masat e mbrojtjes së ajrit:

- Realizimi i komunikacioneve të kyçjes, qasjes dhe interne të kryhet sipas ngarkesës meritore të komunikacionit, ashtu që të sigurohet kalimi i mirë i komunikacionit;
- Të sigurohet përqindja adekuate e hapsirave të gjelbërimit dhe të pa ndotura në parcelat me drunj autoktonë dhe shkurre, llojet me rritje të shpejtë, të rezistueshme në ndotje, gjatë së cilës duhet ikur nga llojet alergjente;
- Në kuadër të sepërfaqes së planifikuar të mbahet niveli maksimal i higjienës komunale.

Masat e mbrojtjes së ujit:

- Gjatë ndërtimit të përmbajtjeve përkatëse, punishten duhet siguruar ashtu që të përjashtohet mundësia e havarisë dhe situatave të ndeshjeve;
- Duhet eskivohet deponimit të materialit ndërtimor në lokacion;
- Nafta dhe derivatet e naftës të transportohen me mjetet transportuese të atestuara
- Të caktohet vendi për deponim të përkohshëm të materialit ndërtimor dhe parkingu i vendpunishtes;
- Të shfrytëzohet kryesisht mekanizimi ndërtimor i rregulluar;
- Në rastin e havarisë së derdhjes së materialeve të dëmshme dhe të rrezikshme urgjentisht të bëhet sanimi i lokacionit;
- Ujërat atmosferike nga platot operative dhe rrugët para se të lëshohen në recipijent patjetër të trajtohen në mbetjet e fundrrinave dhe separatorët e vajit dhe yndyrës;
- Është e detyrueshme mbajtja dhe kontrollimi i aparateve për trajtimin e ujërave të zeza.

Masat e mbrojtjes dhe shfrytëzimit të ujërave nëntokësore

Kaktimi dhe radhitja e rezervave të ujërave nëntokësore në kategori dhe klasë, hartimi i elaboratit mbi rezervat e ujërave nëntokësore, mbajtja e evidencës mbi gjendjen e rezervave nëntokësore dhe pasqyrimi i të dhënave të hulumtive gjeologjike, paraqet detyrim me qëllim të shfrytëzimit të mirëmbajtur të resurseve natyrore. Shfrytëzimi i ujërave nëntokësore si resurs natyror mund të realizohet ndaj:

- Kushteve të mbrojtjes së natyrës sipas të cilave kryhen hulumtimet gjeologjike
- Leja për hulumtime hidrogeologjike detaje

- Elaborati mbi rezervat e ujërave nëntokësore dhe burimeve termo-minerale

Mbrojtja e burimeve të furnizimit me ujë

Toka dhe sipërfaqet ujore në zonën e mbrojtjes së burimeve të furnizuesve të ujit, në pajtim me rregullativën ligjore valide, mbrohet nga ndotja e qëllim të ose e rastësishme dhe ndikimeve të tjera që mund të ndikojnë keq në bollukën e burimit dhe pastërtinë e ujit. Është i obligueshëm rregullimi dhe mirëmbajtja e zonave të mbrojtjes sanitare dhe zbatimi i masave të ndalimit, parandalimit, sanksionit, pengimit, kontrollit dhe mbikqyerjes, mbrojtjes dhe monitorit. Të gjitha burimet –(hapsira rreth objektit të ujëmbledhësit- pusave publike për furnizim me ujë), gjegjësisht hapsirës në të cilën gjendet burimi i furnizimit me ujë, patjetër duhet të mbrohen nga ndotësi i rastësishëm ose i qëllim të dhe ndikimeve të tjera që mund të negatimisht të ndikojnë në bollukin e burimit, përbërjen natyrore dhe kualitetin e ujit. Për mbrojtjen e burimeve të furnizimit me ujë është e nevojshme të hartohet elaborati mbi zonat e mbrojtjes sanitare, me të cilën caktohet sipërfaqja dhe përhapja hapsinore e zonës së mbrojtjes sanitare.

Me qëllim të mbrojtjes së ujit në burim vendosen:

- Zona për mbrojtjen e drejtpërdrejt të mbrojtjes sanitare (zona I)
- Zona e ngushtë e mbrojtjes sanitare (zona II) dhe
- Zona e gjerë e mbrojtjes sanitare (zona III)

Me qëllim të mbrojtjes së ujit në burimin e furnizuesit së ujit, definohen zonat e mbrojtjes së burimeve të ujërave nëntokësore.

Zona mbrojtëse e ujërave nëntokësore, formohet përrreth objektit të ujëpërfshirjes. Lejohet rregullimi i gjelbërimit me lloje dekorative të cilat nuk kanë rrenjë të thella. Zona shfrytëzohet kryesisht për sanëkositje. Hapsira në këtë zonë rrethohet me rrethojë mbrojtëse në largësi prej 3-10m nga objekti i ujëpërmbledhësit, me qëllim të pengimit të hyrjes së pakontrolluar të njerëzve dhe kafshëve. Në këtë zonë nuk mund të ndërtohen dhe të shfrytëzohen objektet, instalimet, veprimtari dhe shfrytëzimi i tokës, nëse kjo rrezikon pastërtinë shëndetsore të ujit të pishëm. Kushtet dhe masat për këtë zonë:

- Ndalohet ndërtimi dhe përdorimi i objekteve dhe instalimeve të cilat nuk janë në funksion të burimit të ujëpërmbledhësit;
- Ndalohet qarkullimi i makinave në funksion të burimit të ujëpërmbledhësit jashtë trasave të caktuara, hyrja e makinave motorike të cilat nuk janë në funksion të ujëpërmbledhjes, shfrytëzimit të lundrave motorike, mbajtja e sporteve në ujë, larja e njerëzve dhe kafshëve;
- Ndalohet ujëpirja e kafshëve;
- Ndalohet kultivimi i peshkut komercial;

- Qasje në këtë zonë i lejohe vetëm personave të punësuar në ujësjellës;
- Ndalohet ndërtimi ose përdorimi i objekteve dhe instalimeve, shfrytëzimi i tokës ose kryerja e veprimtarive tjera të ndaluara në zonat II dhe III.

Zona II burimi i ujërave nëntokësore, përfshin hapsirën nëpër të cilën uji rrjedh deri në objektin ujëpërmbledhës për më pak se 50 ditë dhe nuk mund të jetë më e shkurtë se 50m. Zona I mund të barazohet me Zonën II kur mjedisi ujëbartës në mesin pore pore të tipit ndërfaqor të mbuluar me shtresën mbrojtëse, e cila neutralizon ndikimin e ndotjes nga sipërfaqja e terrenit. Në këtë zonë nuk mund të ndërtohen dhe të shfrytëzohen objektet, instalimet, veprimtaritë dhe shfrytëzimi i tokës, nëse kjo rrezikon pastërtinë shëndetësore të ujit të pishëm. Kushtet dhe masat për këtë zonë;

- Ndalohet ndërtimi i banesave
- Ndalohet përdorimi i plehrave artificiale, të gjendjes së lëngët dhe të ngurtë
- Ndalohet përdorimi i pesticidëve, herbicidëve dhe insektocidëve;
- Ndalohet kultivimi, lëvizja dhe kullotja e kafshëve;
- Ndalohet kampimi, panairët dhe çdo grumbullim i njerëzve;
- Ndalohet ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve sportive;
- Ndalohet ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve hoteliere e tjera për akomodim të mysafirëve;
- Thëllimi i shtratit dhe nxjerrja e rërës dhe zhavorit;
- Formimi i varrezave të reja dhe zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese;
- Ndalohet ndërtimi ose përdorimi i objekteve dhe instalimeve, shfrytëzimi i tokës ose kryerja e veprimtarive të tjera të ndaluara në zonën III.

Zona III burimi i ujit nëntokësor, në mjedisin pore pore të tipit ndërfaqor, kur uji nëntokësor me nivelin e lirë kurse mjedisi ujësjellës i mbuluar me shtresën mbrojtëse, që zvoglon ndikimin e ndotjes nga sipërfaqja e terrenit dhe përfshirjen e hapsirës nga e cila derdhet uji deri në objektin ujëpërmbledhës për më së paku 200 ditë. Zona III mund të barazohet me Zonën II, kur mjedisi ujëbartës del në mjedisin pore pore të tipit ndërfaqor të mbuluar me shtresën mbrojtëse që neutralizon ndikimin e ndotjes nga sipërfaqja e terrenit. Në këtë zonë nuk mund të ndërtohen ose të përdoren objektet dhe instalimet, shfrytëzimi i tokës ose të kryhen veprimtaritë tjera, nëse këto rrezikojnë pastërtinë shëndetësore të ujit në burim, dhe atë:

- Deponimi i përthyerës mbritokësor dhe nëntokësor të materialeve të rrezikshme të

cilat nuk guxojnë të hyjnë në ujë në formë direkte ose indirekte;

- Prodhimi, transporti dhe manipulimet me materialet e rrezikshme dhe materjet të cilat nuk guxojnë të hyjnë në ujë në formë direkte ose indirekte;
- Deponimi komercial i naftës dhe derivateve të naftës;
- Lëshimi i ujërave të zeza dhe ujërave të cilat kanë shërbyer për ftohjen e instalimeve industriale;
- Ndërtimi i rrugëve të trafikut pa kanale për kullimin e ujit atmosferik;
- Eksploatimi i naftës, gazit, materjeve radioaktive, thëngjillit dhe lëndëve minerale;
- Deponimi i pa kontrolluar i mbeturinave komunale, makinave të havaruara, gomave të vjetra dhe materieve dhe materialeve tjera nga të cilat mund të lirohen materiet ndotëse me shpërlarje ose derdhje;
- Prerja e pakontrolluar e pyjeve;
- Ndërtimi dhe shfrytëzimi i skeleve ajrore;
- Punët sipërfaqësore dhe nënsipërfaqësore, minimi i dheut, depërtimi në shtresën që mbushëujin nëntokësor dhe heqjen e shtresës që mbushë shtresën ujësjellës, përveç nëse këto punë nuk janë në funksion të furnizimit me ujë;
- Mbajtja e garave të automobilëve dhe motorëve.

Masa mbrojtëse të veçanta të burimeve të furnizuesit me ujë definohe në mbrojtjen nga ndikimet negative potenciale, të cilat mund të kenë aktivitete të planifikuara në rrethin e tyre. Drejtimet të cilëve duhet t'i përmbahen:

- Të definohe zonat mbrojtëse të burimeve me regjim të caktuar të shfrytëzimit dhe masat me të cilat pamundësohet veprimi i dëmshëm në pastërtinë higjienike të ujit të pishëm;
- Është e detyrueshme vënia e shtresës që nuk lëshon ujë me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së kualitetit të ujërave nëntokësore;
- Kullimi i ujëravë të zeza nga sipërfaqet e rrugëve të bëhet me kanale që nuk lëshojnë ujë;
- Transporti i materialeve ndotëse të bëhet me mjete transportuese të atestuar;
- Gjelbërimi i detyrueshëm në zonën e kalimit të rrugëve pranë burimit të furnizuesit me ujë.

Me qëllim të mjedisit jetësor dhe masave të detyrueshme për zonën II dhe III të shkallës të mbrojtjes sanitare të burimeve të furnizuesit me ujë, të gjitha aktivitetet në komplekset lëndore i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor. Për realizimin e projektit në komplekset e veprimtarive afariste-prodhuese, është e detyrueshme

të fillohet procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor tek organet kompetente për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe pruarjen e vendimit për hartimin/jo hartimin e studimit për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor, nëpajtim me Urdhëresën për caktimin e Listës së projekteve, për të cilat është i detyrueshëm vlerësimi i ndikimit dhe lista e projekteve për të cilat mund të kërkohet vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor (“Sl. Glasnik RS”, nr.114.2008), për burimet e rëndësishme potenciale tëndotjes se ujërave nëntokësore dhe burimeve të furnizuesve me ujë.

Masat për mbrojtjen e tokës:

- Në fazën e ndërtimit përmbajtësit racionalisht të shfrytëzohet toka- shtresa e humusit të ruhet për rregullimin e më vonshëm të lokacionit;
